

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1236 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 138, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA "Rregullore mbi Kriteret e Ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" të Z. Tom Poreçi,*

VENDOSI:

1. Të mos miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" të Z. Tom Poreçi*, për arsye të mospërbushjes së pikës të nenit 13, të Rregullores së sipërpërmendur, sipas të cilës, individë duhet të jetë pajisur me "Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) për arkeologjinë brenda ose jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji dhe nëndegët e saj".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO